



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:009506

Datë: 20.06.2024

Numri i dokumentit: 05839325

C.nr. 4/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoreshen profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh.M nga Rahoveci, të cilin sipas autorizimit i përfaqëson avokati A.M nga Rahoveci, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, me bazë juridike për kompensim i shpenzimeve të ushqimit në punë dhe inflacionit, vlera e objektit të kontestit 1.434.20 euro, jashtë seancës, më datën 20.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit Sh.M.
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit Sh.M, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 05.05.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 374 ditë pune të ja paguajë shumën prej 748,00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, ndërsa në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Maj - Dhjetor 2021 në shumën prej 59.97 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - Tetor 2022 në shumën prej 292,32 euro, në shumën e përgjithshme prej 1,101.29 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 03.01.2024, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përbarimit.
- III. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit Sh.M, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë përtej shumës prej 352.29 euro e deri në shumën 686.20 euro, dhe atë në shumën prej 333.91 euro.
- IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës paditësit, Sh.M, t'i paguajë shumën prej 124,00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi Sh.M përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, më datën 03.01.2024, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, ka parashtruar padinë për shkak të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, vlera e kontestit 748.00 euro, dhe kompensimin e diferencës në emër të shkallës së inflacionit, vlera e përgjithshme e kontestit prej 1.434.20 euro.

I njëjti sipas padisë ka theksuar se paditësi Sh.M ka punuar dhe vazhdon të punojë në SH.U.M “Faik Sylka” në Rahovec, e që për periudhën e kërkuar paditësit i ka takuar e drejta e kompensimit të ushqimit në punë dhe kompensimin e diferencës në emër të inflacionit sipas Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës të datës 21.01.2021, por që deri më tani nuk është kompensuar. Periudha e kërkuar sipas padisë është nga data 05.05.2021 e deri më 21.11.2022 dhe atë për 374 ditë të prezencës në punë dhe për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se në bazë të nenit 35 par. 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, të nënshkruar me datë 18.04.2017 dhe 22.01.2022 nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, punonjësve të arsimit në Kosovë i njihet e drejta e kompensimit mbi bazën e inflacionit vjetor, të iu paguhen të ardhurat sipas rritjes ekonomike të inflacionit vjetor. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë ta aprovojë në tërsi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 03.06.2024, ka theksuar se e kontestojmë padinë në tërësi për shkak se më 21.11.2022 MASHT-i ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Ndërkaq kërkesat që dalin nga kontestet e marrëdhënies së punës fillimisht duhet të parashtrohen tek punëdhënësi. Gjykata mund të shqyrtoj një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse paditësit i kanë shterur të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ. Në këtë rast paditësi nuk ka parashtruar kërkesë për kompensim pranë të paditurës. Me rastin e lidhjes së kontratave kolektive në nenin 2 të dy kontratave janë deleguar kompetenca dhe detyrime për të paditurën pa u shoqëruar edhe me buxhet shtesë, këto detyrime nuk janë zbatuar nga niveli qendror i pushtetit.

Paditësi ka parashtruar padi në këtë gjykatë me datë 03.01.2024, andaj konsiderojmë që kërkesëpadia e paditësve është parashkruar në tërsi ngase nga hyrja në fuqi e KKAK, të datës 18.04.2017 deri në parashtrimin e padisë në këtë gjykatë kanë kaluar më shumë se 3 vite. Paditësit nuk i kanë shtjerrë të gjitha mundësitë ligjore në procedurë administrative, e që gjykata mund të shqyrtoj një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse paditësi i ka shtjerrë të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ. Andaj, e konteston kërkesëpadinë e paditësit pasi që i mungon legjitimiteti real-pasiv për faktin se komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin, autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushqimin e delegimit. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 146/2023 i datës 08.12.2023, i lëshuar nga SHUM “Faik Sylka” në Rahovec për paditësin Sh.M; kontratën e punës me Nr. të protokollit:111/1 e datës 01.09.2022, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit Sh.M, listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për muajin janar 2022.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësi për periudhën e kërkuar kohore ka prezantuar në punë. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësit pagesa e ushqimit për çdo ditë të prezencës në punë dhe a ka legjitimitet real pasiv e paditura.

Me administrimin vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 146/2023 i datës 08.12.2023, i lëshuar nga SHMU “ Faik Sylka” në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se paditësi Sh.M në periudhën kohore prej datës 05.05.2021 e deri më 21.11.2022, ka prezantuar në punë në 374 ditët e punës.

Me administrimin e kontratën e punës me Nr. të protokollit: 111/1 e datës 01.09.2022, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit Sh.M, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHMU “Faik Sylka” në Rahovec.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit për faktin se paditësi Sh.M, në periudhën kohore nga data 05.05.2021 e deri më 21.11.2022, në vendin e tij të punës ka prezantuar, 374 ditë të punës. Kjo është vërtetuar sipas vërtetimeve të lëshuar nga vetë shkolla ku paditësi ka qenë duke punuar, ndërsa vërtetësinë e këtij dokumenti e ka kontestuar e paditura. Baza juridike e kërkesëpadsisë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Ndërsa sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore”*.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontratat e punës për paditëset të lëshuar nga Komuna e Rahovecit – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “ Faik Sylka”, në Rahovec. Bazuar në Listat e

pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2022 vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumën prej 252.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit Sh.M, i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë në pjesën tjetër në shumën prej 333.91 pasi që paditësi Sh.M përfitonë ngritje në bazë të pagës bazë (252) euro dhe jo (421) euro siç ka kërkuar në padi, po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate paditësi gjatë vitit 2022, përfitonë ngritje në bazë të inflacionit për dhjetë (10) muaj, e jo për dymbëdhjetë (12) muaj, siç ka kërkuar në padi, edhe pse më datën 22.01.2021 është lidhur Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, njëra palë kontraktuese më datën 22.11.2022 është tërhequr nga zbatimi i kësaj Kontrate Kolektive. Në këtë Kontratë Kolektive kanë qenë të parapara edhe hapat e kontestimit të shkëputjes së kësaj Kontrate, mirëpo nga pala tjetër nënshkruese nuk janë paraqitur prova me të cilën do ta dëshmonin se është kontestuar vlefshmëria e Kontratës Kolektive. Këtë qëndrim e mban edhe Gjykata Supreme e Kosovës, e cila në mendimin e saj juridik me numër 214/2023 të datës 05.10.2023, ka theksuar se *“Në rrethana të tilla, kjo gjykatë vlerëson se rastet e të punësuarve që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave që dalin nga kjo kontratë duhet trajtuar sipas kësaj kontrate dhe atë deri me datën 21.11.2022, kur është shkëputur nga njëra prej palëve kontraktuese, marrë për bazë arsyet e paraqitura më lartë”*.

Sa i përket çështjes së parashkrimit, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës për faktin se padia e paditësit është dorëzuar më datën 03.01.2024, ndërsa kërkesëpadia e paditësit përfshin periudhën kohore deri me datën 31.12.2022, e që është brenda afatit kohor 3 vjeçar. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave

në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Prandaj edhe kërkesa është brenda afatit 3 vjeçar.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ku është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadiisë së paditësve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtuftjeshëm LPK), ku është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadiia”, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se “Kërkesëpadiia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadiia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.

Sa i përket legjitimitetit real pasiv të palës së paditur, gjykata vlerëson se pala e paditur ka legjitimitet që të jetë e paditur në këtë çështje kontestimore për faktin se sipas nenit 2 par.1 pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, dispozitat e kësaj kontrate kolektive të arsimit janë të obligueshme për të gjithë punëdhënësit e sektorit të arsimit në Kosovë, përfshirë edhe komunat dhe drejtoritë komunale të arsimit.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palës së paditur, por nuk ishin relevante në zgjidhjen e kësaj çështje kontestimore.

Vendimin lidhur me kumatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2 dhe neni 35 par.5 dhe par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, nenit 398 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, i cili përcakton se: “Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyq fituese, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyq fituese, duke vendosur që paditësja t’ia kompensojë të paditurit shumën si në pikën VI të dispozitivit të këtij aktgjykimi,

në shumën e përgjithshme prej 125,00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 104 euro si dhe për taksën gjyqësore 21.00 euro.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.4/2024, më datën 20.06.2024

B.Profesionale
Shpresa Haxhijaha Rahmani

Gjyqtari
Avni Berisha

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.